



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr.156, datë 17.12.2021

**PËR**  
**MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE SHITESË TË ALOKUARA NGA**  
**BUXHETI I SHTETIT NË ZBATIM TË AKTIT NORMATIV NR. 34, DATË 3.12.2021**  
**“PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 137/2020 “PËR BUXHETIN E VITIT**  
**2021”, TË NDRYSHUAR**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021” i ndryshuar, Aktit Normativ Nr.34, datë 3.12.2021 “Për disa ndryshime në ligjin nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” të ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.123, datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2021, si dhe projektbuxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2021-2023”, si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Buxhetit, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Përdorimin e fondit shtesë prej 52.111.335 lekë të alokuara nga buxheti i shtetit në zbatim të Aktit Normativ nr.34, datë 3.12.2021 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” të ndryshuar, si më poshtë:

<b>Programi buxhetor</b>	<b>Emërtimi projektit</b>	<b>Llog. Ekonomike</b>	<b>Fondi në lekë</b>
04960	Shlyerje e detyrimeve të prapambetura	602	13.111.335
05100	Menaxhimi i mbetjeve urbane	602	39.000.000
	<b>TOTALI</b>		<b>52.111.335</b>

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Buxhetit, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 17.12.2021**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 980 / prot.



Durrës, më 20 .12. 2021

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK**  
**DURRËS**

BASHKIA DURRËS  
 20.12.21 Nr. 13186/2

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.156 datë 17.12.2021 “Për miratimin e përdorimit të fondeve shtesë të alokuara nga buxheti i shtetit në zbatim të Aktit Normativ Nr.34 dt 03.12.2021 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” të ndyshuar.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**ROLAND NASTO**

